

**V E N D I M**  
**Nr.429, datë 26.6.2003**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË QYTETIN E KAVAJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i ujësjellësit në qytetin e Kavajës.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., Kavajë.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4176 m<sup>2</sup> tokë arë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 923 200 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e tre mijë e dyqind) lekësh.
  4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
  5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 225 600 (dyqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i ujësjellës-kanalizimeve sh.a., Kavajë.
  6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 10.7.2003.
  7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Prefektura e Qarkut të Tiranës dhe ujësjellës-kanalizimi sh.a., Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E UJËSJELLËSIT TË KAVAJËS**

| Nr. | Emri, atësia, mbiemri       | Sip/Tokës m <sup>2</sup> | Çmimi lekë/m <sup>2</sup> | Vlera lekë |
|-----|-----------------------------|--------------------------|---------------------------|------------|
| 1.  | Fetah Faik Beu (Harizi)     | 400                      | 700                       | 280 000    |
| 2.  | Lutfi Resmi Beu (Harizi)    | 1258                     | 700                       | 880 600    |
| 3.  | Dylejman Halit Beu (Harizi) | 420                      | 700                       | 294 000    |
| 4.  | Rifat Arif Beu (Harizi)     | 260                      | 700                       | 182 000    |
| 5.  | Salami Hakik Beu (Harizi)   | 700                      | 700                       | 490 000    |
| 6.  | Izet Aqif Harizi            | 348                      | 700                       | 243 600    |
| 7.  | Bardhyl Rexhep Shaba        | 790                      | 700                       | 553 000    |
|     | Shuma                       | 4176                     |                           | 2 923 200  |